



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

Nr. 95/1 Prot.

Tiranë, më 15.04.2020

**PROCESVERBAL**

Sot, më datën 15.04.2020, ditë e mërkurë, ora 11.00, Këshilli i Lartë i Prokurorisë zhvilloi mbledhjen plenare të radhës, nëpërmjet platformës online në lidhje skype/zoom, thirrur nga Kryetari, bazuar në nenet 164 deri në 167 të Ligjit Nr.115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, i ndryshuar.

Këshilli mbledhet në prani të anëtarëve si më poshtë:

1. Gent Ibrahimi
2. Alfred Balla
3. Nurihan Seiti
4. Tartar Bazaj
5. Bujar Sheshi
6. Kosta Beluri
7. Sandër Beci
8. Vate Staka

Mbledhja u zhvillua nën drejtimin e Kryetarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Z. Gent Ibrahimi, i cili, në zbatim të nenit 166 të Ligjit Nr.115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, i ndryshuar, pasi verifikon pjesëmarrjen e anëtarëve, bën hapjen e saj në kushtet e kuorumit dhe kalon në prezantimin e rendit të ditës:

**Rendi i Ditës:**

1. Shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit “Për caktimin e përkohshëm të Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastrë”.



2. Shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit “Për dhënie leje të papaguar, për arsye familjare, për një Prokuror në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Vlorë”.

3. Shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit “Për krijimin dhe administrimin pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë të Dosjes Personale dhe të Regjistrit të Prokurorëve”.

**Z. Ibrahim** pyet nëse ka sugjerime, komente dhe pyetje për rendin e ditës.

**Z. Ibrahim** vijon me pikën e parë të rendit të ditës.

- *Miratimin e projektvendimit “Për caktimin e përkohshëm të Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastër”.*

**Z. Ibrahim** i jep fjalën z. Beci të relatojë në emër të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

**Z. Beci** relaton në lidhje me prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastër. Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka pasur disa vendimmarrje, të lidhura me faktin që Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, më dt 08.07.2019, ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastër. Në këto kushte, Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka marrë Vendimin nr.123, nr. 208 dhe Vendimin nr. 2 të dt. 15.01.2020, ku ka caktuar përkohësisht z. Gjon Fusha si Drejtues të kësaj Prokurorie. Periudha e fundit ka qenë nga dt. 16.01.2020-15.04.2020. Në pamundësi të ushtrimit të detyrës nga ana e personit në fjalë, i cili është në procesin e rivlerësimit me një vendim shkarkimi të KPK-së, Këshilli është i detyruar që ta konsiderojë këtë pozicion si përkohësisht të lirë, në bazë të nenit 59, pika 1 dhe 2 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, deri në marrjen e vendimit të formës së prerë nga KPA. Në këto kushte, KZHK vendosi që të caktojë për herë të katërt z. Gjon Fusha dhe i propozon Këshillit ta miratojë.

**Z. Ibrahim** lexon projektvendimin: Këshilli i Lartë i Prokurorisë, mbështetur në nenin 149/a të Kushtetutës, në nenin 59 pika 1 dhe 4 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenet 164/8, në nenin 166/2, në nenin 189/1 gërma a, të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, dhe në Rregulloren e dt.15.04.2019 “Për caktimin e përkohshëm të Prokurorëve”, i ndryshuar, me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, vendosi: Caktimin e z. Gjon Fusha, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastër, që të ushtrojë përkohësisht funksionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastër, për një periudhë kohore nga data 16.04.2020 – 15.07.2020. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Z. Ibrahim** hedh në votim miratimin e projektvendimit



**Miratohet me 8 vota pro.**

**Z.Ibrahimi** vijon me pikën e dytë të rendit të ditës.

- *Miratimi i projektvendimit "Për dhënie leje të papaguar, për arsye familjare, për një Prokuror në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë".*

**Z. Ibrahimi** i jep fjalën z. Balla, që të relatojë në emër të Komisionit të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale.

**Znj. Seiti** interesohet të dijë konkretisht se, kur i fillon leja, kur ka ikur dhe për mënyrën e marrjes së lejes nga z. Mustafaj.

**Z.Balla** relaton mbi projektaktin e propozuar nga Komisioni që ai drejton. Z. Mustafaj ndodhet me leje të zakonshme në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, për arsye familjare. Në kushtet e pandemisë COVID 19, ai kërkon dhënien e lejes së papaguar për një periudhë 1 (një)- vjeçare, duke filluar nga data 01 Maj 2020 deri 30 Prill 2021, për arsye të mbylljes së kufijve.

Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale, në mbështetje të nenit 24 të ligjit Nr 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, nenit 189/1, gërma a, të ligjit nr.115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, pasi shqyrtoi bazën dokumentare dhe duke vlerësuar rrethanat e krijuara nga pandemia botërore, propozon miratimin e lejes së papaguar për magjistratin prokuror z. Elion Mustafaj, gjatë periudhës 1 (një)-vjeçare 01 Maj 2020 deri 30 Prill 2021.

**Z. Ibrahimi** komenton dhe tërheq vëmendjen që Këshilli përgjithësisht të jetë më i kursyer në dhënien e këtyre lejeve, duke e argumentuar këtë me nevojën që ka aktualisht sistemi i prokurorisë për burime njerëzore. Por, në rastin konkret, për shkak të pandemisë, kjo leje është e justifikuar, pasi praktikisht personi në fjalë, edhe sikur të donte të vinte, kjo është objektivisht e pamundur.

**Z. Ibrahimi** vazhdon me leximin e projektvendimit sipas propozimit të Komisionit dhe e hedh në votim për miratim.

**Miratohet me 8 vota pro.**

**Z.Ibrahimi** vijon me pikën e tretë të rendit të ditës.

- *Shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit "Për krijimin dhe administrimin pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë të Dosjes Personale dhe të Regjistratit të Prokurorëve".*



**Z. Ibrahim** thekson që kjo është një çështje shumë e rëndësishme për Këshillin, pasi ka të bëjë me organizimin e dosjeve personale të prokurorëve, të cilat administrohen nga Këshilli, sigurisht duke u njohur atyre të drejtën për të patur akses në dosjet e tyre. Z. Ibrahim mendon se ndoshta nuk është e mundur që ky dokument të miratohet sot, por gjithësesi është me vlerë që të fillojë diskutimi rreth tij, pasi materjalin e keni patur në dispozicion tashmë prej mëse një jave.

**Z. Ibrahim** pyet nëse ka komente dhe pyetje.

#### **Rreth kësaj çështjeje u diskutua:**

**Znj. Seiti** pyet, nëse mund të konsultohen edhe magjistratët në lidhje me këtë çështje, përpara se të diskutohej nga Këshilli?

**Z. Ibrahim:** Duke qenë të hapur për kontributin e gjithkujt të interesuar, personalisht jam pak hezitues në lidhje me rastin konkret, pasi kjo është një çështje që nuk ka të bëjë aq direkt me statusin e tyre, se sa me organizimin e punës dhe dokumentacionit në Këshill. Ata kanë të drejtën e tyre të kenë akses.

**Znj. Seiti:** Magjistratët do e bëjnë volumin material, dhe në këtë mënyrë le të njihen dhe të krijojnë një ide paraprakisht me punën. Së paku, ky është mendimi im.

**Z. Staka** shprehet se nuk e shikon të arsyeshme propozimin e znj. Seiti për marrjen e mendimit të magjistratëve, pasi kemi të bëjmë me procedura standarde. Është i njëjti standard i vendosur prej kohësh për të gjithë, kështu që nuk do të përfitohej ndonjë gjë e re.

**Z. Bazaj** nuk ka ndonjë koment për propozimin e znj. Seiti, por propozon si një mënyrë produktive, krijimin e një faqeje, përveç dosjeve, ku të pasqyrohej aktiviteti i punës së çdo prokurori, ngarkesa e punës, rezultati konkret etj. Thjesht një ide kjo, pra të zgjerohet dosja, ku të paraqitet numri i çështjeve që ka patur prokurori, si i ka zgjidhur, sa ka zgjidhur etj. Madje, sugjeron që kjo teknikisht të enkriptohet me një kod, për t'u aksesuar sa herë që të jetë nevoja për njohje nga ana e KLP-së.

**Z. Ibrahim** i sjell në vëmendje z. Bazaj se mund të referohet tek faqja 3, kreu 2, paragrafi d i materjalit, duke sugjeruar se atje gjen përgjigje edhe ky shqetësim i tij, konkretisht ku flitet për përvojën profesionale dhe zhvillimin e karrierës, të cilat janë ezauruar në këtë projektakt.

**Z. Staka** merr fjalën dhe e pyet z. Bazaj, nëse i referohet viteve të kaluara apo flet për vitet e ardhshme? Më tej ai i kujton ligjin nr.84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve", por edhe ligje të tjera, duke argumentuar, se vlerësimet e prokurorëve janë bërë në mënyrë periodike, përkatësisht një herë në 3, 5 apo 10 vjet. Ndërkohë, thekson se do të ishte kundërproduktive, qoftë edhe nga ana teknike që KLP t'i futej dosjeve për ngarkesën konkrete të punës të qindra prokurorëve që ka Republika. Lidhur me paraqitjen e dosjeve personale në faqe elektronike, sigurisht që ato pasurohen edhe me aktet tona përkatëse si Këshill, por nga ana tjetër



duhet të bërë kujdes që, për elementë të ndryshëm, kjo të mos bjerë ndesh me ligje të tjera, si ai për mbrojtjen e të dhënave personale.

**Znj. Seiti** shprehet se dosja e magjistratit çdo vit pasurohet me të dhëna të reja, pasi e tillë është natyra e punës së magjistratit.

**Z. Ibrahim** sqaron se çdo prokuror ka të drejtë të njihet me përmbajtjen e dosjes së tij apo të saj, duke parashikuar një rol më proaktiv të vetë prokurorit në plotësimin dhe pasurimin e dosjes së tij/saj personale.

**Z. Sheshi** shprehet se krijimi i dosjeve për prokurorët nuk është një gjë e re, pasi çdo prokuror, para se të fillojë punën, disponon një dosje personale. Ndryshimi është, se dje këtë rol administrues e kishte Prokuroria e Përgjithshme, ndërsa sot e ka KLP. Mendon që formati i këtij projektvendimi është i saktë. Ai propozon që në dosje të parashtrihen dhe vlerësimet periodike dhe që Sektori i Burimeve Njerëzore t'i ndjekë elementet plotësues të materialeve për t'i përfshirë në dosje të gjitha vlerësimet dhe kualifikimet nga trajnimet vazhduese të prokurorëve, sigurisht në bashkëpunim me vetë prokurorët e interesuar.

**Z. Ibrahim** thekson se sektori i Burimeve Njerëzore do të ketë një rol më aktiv në këtë proces, sikurse parashikon edhe projektakti në fjalë.

**Z. Beluri** është dakord me draftin dhe shprehet kundër pasqyrimin të statistikave të punës së magjistratit në dosje. Ai mendon që edhe magjistratët duhet të kenë një rol aktiv dhe të jenë të interesuar për dosjet e tyre personale.

**Z. Ibrahim** pyet në përfundim, nëse ky draft ka nevojë për ndonjë rregullim tjetër formal. Më pas, hedh në votim miratimin e projektvendimit në formën e paraqitur.

**Miratohet me 8 vota pro.**

Në përfundim, duke mos patur pika të tjera për diskutim, Kryetari e deklaroi mbledhjen të mbyllur.

**Mbajtësi i procesverbalit**

(Sonila Çeliku)

**KRYETARI**

**Gent Ibrahim**



**Shënim:**

**(Shënimi i mëposhtëm vendoset pas përfundimit të të gjithë procedurave të rishikimit)**

Lidhur me këtë procesverbal janë/nuk janë vënë në dukje pasaktësi nga anëtarët e KLP-së.  
Pasaktësitë e vërejtura janë reflektuar me urdhër të kryetarit Nr. \_\_\_ Datë \_\_\_/\_\_\_/2020/me vendim të Këshillit të Lartë të Prokurorisë Nr. \_\_\_ datë \_\_\_/\_\_\_/2020 (Bashkëngjitur kopjet e dokumenteve)  
Procesverbali i mësipërm u miratua në mbledhjen e radhës të KLP-së datë \_\_\_/\_\_\_/2020  
Procesverbali të arkivohet.

**PËRGJEGJËSI I SEKTORIT TË SHËRBIMEVE ADMINISTRATIVE**

**Frederik Sulisufi**

